



Sekretari

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
BORDI I MENAXHIMIT

Nr. 830/2 Prot.

Tiranë, më 13. 2. 2020

VENDIM

Nr. 5 datë 13. 2. 2020

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE SI DHE DEKLARIMIN E PASURIVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR

Bazuar në nenin 11 të Ligjit nr.10164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.28, datë 17.01.2018 "Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar", i ndryshuar.

VENDOSI

1-Të miratojë sipas materialit bashkelidhur, rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin Rrugor Shqiptar.

2-Ngarkohet Autoriteti Rrugor Shqiptar per zbatimin e këtj Vendimi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjehere.

KRYETARI I BORDIT TE MENAXHIMIT

ARTAN SHKRELI

ANËTARËT

ELTON HAXHI

GENTIAN OPRE

JULIAN HODAJ

LUIJG ALEKSI

HAZBI PARLLAKU

FARUK KABA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

“Për përdorim të brendshëm”

RREGULLORE

PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E
FUNKSIONEVE PUBLIKE SI DHE DEKLARIMIN E PASURIVE NË USHTRIMIN
E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR



Autoriteti Rrugor Shqiptar Rruga Sami Frasheri, Nr.33, Tiranë. Email:info@arrsh.gov.al Tel: 04 22 34 487

NR. KAPITULLI

PËRMBAJTJA

Kapitulli	I	Rregulla të përgjithshme
Kapitulli	II	Procedurat dhe mjetet për identifikimin ,regjistrimin dhe trajnimin e konflikteve të interesave



KREU I **RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Baza ligjore**

Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin Rrugor Shqiptar”, bazohet në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore përkatëse të miratuara në bazë të tyre.

Neni 2 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është deklarimi dhe mbajtja e përgjegjësive për deklarimin dhe kontrollin e pasurive si dhe garantimi i një vendimmarjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga zyrtarët publikë të Autoritetit Rrugor Shqiptar si dhe ushtrimi i funksioneve nga punonjësit e Autoritetit Rrugor Shqiptar jo në kushtet e konfliktit të interesave.

Neni 3 **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për zbatimin e detyrimeve ligjore për deklarimet e pasurive si dhe identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Neni 4 **Përkufizime**

1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Konflikti i interesit përfshin edhe disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) “Konflikt faktik i interesit” është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare.

- b) "Konflikt në dukje i interesit" është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.
- c) "Konflikt i mundshëm i interesit" është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.
- ç) "Konflikt rast për rast i interesit" është gjendja me konflikt interesit, në njëren nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarje të veçantë.
- d) "Konflikt i vazhdueshëm i interesit" është gjendja në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

2. "Zyrtar" është çdo person që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. "Epror i një zyrtari" është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucionit, që ka kompetencia emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë zyrtar ose që i janë dhënë kompetanca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.

4. "Person i lidhur me një zyrtar" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesit, pasurore ose vetjake jo pasurore me zyrtarin, sipas pikës 11 të nenit 3 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 në lidhje me nenin 5 të po këtij ligji.

5. "Parim i proporcionalitetit", sipas pikës 12 të nenit 3 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

Neni 5 Fusha e zbatimit

1. Regullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtar, sipas kuptimit të këtij termi në pikën 2, 3 dhe 4 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, kur ai merr pjesë në një vendimmarje për akte e kontrata administrative, si dhe akte normative dhe konkretisht :

nga:

- Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- Drejtorët e drejtorive të Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- Përgjegjësit e sektorëve të Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- Specialistët në sektorët e Autoritetit Rrugor Shqiptar,

sipas strukturës së miratuar me VKM Nr.276 datë 16.05.2018, “Për miratimin e mënyrës së organizimit të strukturës, organikës dhe statutit te Autoritetit Rrugor Shqiptar”.

2. Fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje përfshin norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

a. Çdo zyrtar i Autoritetit Rrugor Shqiptar që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në Ligjin nr.10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar, Ligjin nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

b. Çdo zyrtar tjetër i Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në një vendimmarje, duke përfshirë çastet paraprake dhe çastin e fundit të procesit vendimmarrës.

c. Personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative.

3. Çdo zyrtar i Autoritetit Rrugor Shqiptar mbart detyrimin për të garantuar paanësinë duke deklaruar dhe shmangur çdo situatë konflikti interesit sipas përcakttimeve të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

Neni 6

Vendimmarja dhe çastet paraprake të vendimmarrjes

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, në përputhje me Udhëzimin e ILDKPKI nr.239 datë 2.2.2006, “Për kuptimin e çasteve paraprake dhe thelbësore në një vendimmarje”:

- a. vendimmarje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilët vendoset përbajtja përfundimtare e aktit;
- b. vendimmarje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësish të rëndësishme dhe përcaktuese për përbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në sa më poshtë:
 - i. hartimi i projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimi organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarje;
 - ii. dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, për këtë projektakt nga zyrtarë të tjera, brenda apo jashtë institucionit;

- iii. dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
- iv. dhënie e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
- v. përfshirje e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqëruar të një vendimmarjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitet, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitet administrative, pa praninë e të cilave nuk do të vendosej dhe mbështetej përbajtja përfundimtare e projektit ose projektkontratës në tëresinë e tyre;
- vi. çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së Institucionit të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Neni 7 **Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt**

1. Një zyrtar i Autoritetit Rrugor Shqiptar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarjen për këtë akt, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, përcaktojnë përbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarjen që buron nga:
 - a. roli urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, mirëadministrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
 - b. zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht por jo vetëm, me të dhëna sensitive për biznesin, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregulator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikat ekonomike vendore dhe administrimin financiar;
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe nga zyrtarët eprorë në këtë institucion.
4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesit të çfarëdo lloji.
5. Në të njëjtat raste, eprori mund t’i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat privatë në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të Ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

6. Në rastet e vlerësimit të rrezikut të mundshëm për rënien në konflikt interesit të zyrtarit veprohet sipas dispozitave të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Neni 8 **Interesat private**

1. Interesat private të një zyrtari janë interesat që parashikohen nga neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, e konkretisht:

- a. të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
- b. çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c. dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- d. negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniash me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
- e. angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- f. marrëdhënie:
 - i. familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii. të komunitetit;
 - iii. etnike;
 - iv. fetare;
- v. të njobura të miqësisë apo të armiqësisë;
- g. angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht ne Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtët interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesit, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesit privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesit ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të

detyrueshme të këtij interesи, shfaqet një gjendje me konflikt interesи, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005.

II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN, REGJISTRIMIN DHE TRAJTIMIN E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave.

Neni 9

Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo zyrtar, sipas përcaktimit të këtij termi në nenin 5 të kësaj rregulloreje, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesи.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtarët, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt.

Neni 10

Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit për interesat privatë të zyrtarit në Autoritetin Rrugor Shqiptar është:
 - a. detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni;
 - b. e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi, në përputhje me qëllimin e Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005.
2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari të Autoritetit Rrugor Shqiptar, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005.

Neni 11
Lëshimi i autorizimit nga zyrtari

1. Autoriteti Përgjegjës në Autoriteti Rrugor Shqiptar vë në dispozicion të zyrtarëve të tij modelin e autorizimit, që këta duhet të lëshojnë, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës.
2. Autorizimi dorëzohet në autoritetin përgjegjës të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Neni 12

**Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen
e gjendjeve të konfliktit të interesave**

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e Ligjit nr.9367 datë 7.4.2005 dhe të kësaj rregulloreje, sipas hierarkisë janë:
 - a. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar;
 - b. Drejtoreti e Drejtoreve në Autoritetin Rrugor Shqiptar.
3. Autoriteti përgjegjës në Autoritetin Rrugor Shqiptar, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në Ligjin nr.9367 dhe në nenin 13 të kësaj rregulloreje është Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme në Autoritetin Rrugor Shqiptar.

Neni 13
Detyrat e autoritetit përgjegjës të Autoritetit Rrugor Shqiptar

Autoriteti përgjegjës i Autoritetit Rrugor Shqiptar kryen detyrat e mëposhtme:

- a) mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të Autoritetit Rrugor Shqiptar .
- b) shpëndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t'u lëshuar nga zyrtarët, sipas nenit 11 të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 dhe nenit 11 të kësaj rregulloreje;

- c) krijon regjistrin përkates dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
- ç) bazuar ne regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve, u sugjeron atyre dhe/ose eproreve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eproret e tyre duhet të tregohen të kujdeshëm për parandalimin e:
- i.- konfliktit rast për rast të interesit (faktik, ne dukje dhe të mundshëm);
 - ii. - konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
 - d) kryen, me autorizim të drejtorit të përgjithshëm verifikimin e interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtareve, duke shfrytezuar të gjitha mundesitë qe i jep ligji.
 - dh) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, ne kuptim te Ligjit nr.9367, date 7.4.2005;
 - e) përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimet e tyre dhe me parandalimin sa më të mire të konfliktit të interesave;
 - ë) merr masa për të siguruar aksesin e informimin e publikut me të dhënat personale të zyrtareve dhe dokumentet e tjera zyrtare, që lidhen me konfliktin e interesit; dhe në bashkepunim me njesine perjegjese për çështjet juridike: të mëposhtme
 - i. merr masa për të lehesuar ankinin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështet Autoritetin, në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshperblimin e paleve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshperblimit të zyrtaret përgjegjës;
 - ii. orientojnë, vlersojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të Autoritetit dhe të institucioneve në varesi, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit;
 - iii. shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit, për zbatimin e Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
 - iv. merr masa për të miratuar në rregulloret e brendshme te Autoritetit, udhëzimet e orientimet e lëshuara nga çdo institucion epror, si dhe nga ILDKPKI;
 - f) mbështet ILDKPKI-në, në kryerjen e deklarimit periodik të interesave nga zyrtarët e Autoritetit;
 - g) njofton me shkrim ILDKPKI-në, për rastet e emerimit dhe largimit nga funksioni të zyrtareve, që mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike në ILDKPKI, sipas rastit;
 - gj) bën me dije zyrtarët e Autoritetit për çdo këshillë apo udhëzim të ILDKPKI-së;
 - h) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të ILDKPKI-se, ne institucionin e tyre ose në institucionet e varësisë;
 - i) ndjek e zbaton detyra të tjera, që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhreve të Titullarit të institucionit në zbatim të Ligjit nr.9367, date 7.4.2005, i ndryshuar.

Neni 14

Administrimi i dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës

1. Dokumentacioni i përdorur nga autoriteti përgjegjës, në zbatim të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, është dokumentacion zyrtar. Zyrtari/zyrtarët e emëruar si autoritet përgjegjës, me rastin e emerimit dhe largimit të tij/tyre duhet të marrë/marrin në dorëzim zyrtarisht nga drejtoria/njësia e burimeve njerëzore dhe të bëjë/bëjnë dorëzimin e plotë të dokumentacionit pranë drejtorisë/njësisë së burimeve njerëzore, e cila më pas ia dorëzon zyrtarit/zyrtarëve të rinj që marrin detyrën e autoritetit përgjegjës,

2. Me qëllim administrimin sa më të mirë të dokumentacionit nga autoriteti përgjegjës, kriohen dhe mbahen nga ky autoriteti përgjegjës, dosje të veçanta me përmbajtje si vijon:

- Dosja nr.1 me titull “*Për aktet ligjore dhe nënligjore*” duhet të përmbajë:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar);
- Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar);
- Ligjin nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
- Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligje të tjera në varësi të veprimtarisë së institucionit publik;
- Komentarët Ligjorë nr. 1, 2, 3, 4, 5, (dhe të tjerë që miratohen në vijimësi) të ILDKPKI;
- Manuale shpjegues dhe trajnimi, Nr. 1, 2, 3, 4 (dhe të tjerë që miratohen në vijimësi) të ILDKPKI; Urdhra dhe udhëzime të ILDKPKI, ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim, si për shembull:
- Udhëzimi nr.7, datë 21.2.2006, “Për funksionet që mbartin detyrimin për deklarim”;
- Udhëzim nr.239, datë 2.2.2006, “Për kuptimin e çasteve paraprake dhe thelbësor në një vendimmarrje”;
- Udhëzimi nr.622, datë 30.11.2012 “Për ngritjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave”;

- Dosja nr.2 me titull “*Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast përrast të interesave*” duhet të përmbajë:

- Regjistrin e konfliktit rast përrast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
- Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarimin rast përrast të interesave;
- Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast përrast të interesave;
- Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast përrast të interesave të zyrtarëve;
- Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë.

- Dosja nr.3 me titull “*Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe interesave të zyrtarëve që kanë detyrimin për deklarim pranë ILDKPKI*” duhet të përmbajë:

- Regjistrin themeltar alfabetik, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
- Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarim dhe konfirmimet e tyre;
- Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;

- Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat; Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

Neni 15

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të Autoritetit Rrugor Shqiptar, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga autoriteti përgjegjës i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe respekton formën tip të miratuar nga ILDKPKI.

Neni 16

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

Autoriteti përgjegjës, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesë, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënavë, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykata.

Seksioni 2

Identifikimi, regjistrimi, kufizimi i interesave privatë dhe trajtimi i rasteve me konflikt interesë

Neni 17

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave Private

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të Autoritetit Rrugor Shqiptar, bëhet sipas kërkesave të kreut I , të Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e Autoritetit Rrugor Shqiptar, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarime periodike të interesave private sipas nenit 3 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 janë:
 - a) Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar;
 - b) Zv.Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar;
 - c) Drejtuesit e institacioneve të Rajoneve Tiranë, Shkodër dhe Gjirokastër në varësi të Autoritetit Rrugor Shqiptar;
3. Në përputhje me nenin nr. 7, pika 5, nenin 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa

nëpunësve publikë”, të ndryshuar, mbartin detyrimi për deklarim të interesave privatë periodikë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhojtë të zyrtarëve të Autoritetit Rrugor Shqiptar, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.

4. Çdo zyrtar i Autoritetit Rrugor Shqiptar, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave privatë periodikë në institucion ose kur kalon në një pozicion që nuk mbart detyrimin për deklarim, është i detyruar që, brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar: “Deklaratë pas largimit nga funksioni”.

5. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Sektori i Financës, në rast se zyrtari nuk plotëson detyrimin ligjor të pikës 4, të këtij neni, të kësaj rregulloreje dhe të ligjit 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, nuk duhet të bëjë dorëzimin e librezës së punës, të librezës së kontributeve shoqërore, të çdo dokumenti tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t'i takojnë zyrtarit, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

Neni 18

Llojet e interesave privatë, që deklarohen periodikisht

Interesat privatë, që deklarohen periodikisht, janë ato të përcaktuara në nenin 4 të Ligjit nr.9049, datë 10. 4. 2003 (i ndryshuar).

Neni 19

Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të vecanta

1. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit :

- a) nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik;
- b) nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse;
- c) nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.

2. Zyrtaret e tjera:

- a) nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion tjetër publik;
- b) nuk mund te ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
- c) mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqëria tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushton veprimtari në një sferë që përpunhet ose pritet me sferën e juridikacionit të zyrtarit të Autoritetit dhe të kompetencës së tij për të vëruar, me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve,

të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri apo mbi shoqëri të tjera, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me shoqërinë në fjalë, rast në të cilin zyrtari mund të zotërojë aksione ose pjesë në kapital vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 27 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;

Neni 20

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtiveve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar i Autoritetit Rrugor Shqiptar të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtive ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesit të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
 - a. "Dhurata", sipas kësaj irregulloreje ka të njëtin kuptim të përcaktuar në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;
 - b. Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.
2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjera, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e zyrtarit.
4. Vlerësimi dhe trajtimi i dhuratave bëhet sipas irregullave të përcaktuara në nenin 23 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 dhe në VKM-në nr. 714, datë 22.10.2004.
5. Në asnjë rast zyrtari i Autorite nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
6. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsyeb protokollare.

Neni 21

Prania dhe kufizimi i interesave private të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e Autoritetit, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 17 e 19 dhe 20 të kësaj rregullore janë përkatësish:

- a) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;
- b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.

2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e Autoritetit, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Përsa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e Autoritetit dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtëpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

4. Personi i lidhur me zyrtarin e Autoritetit, nuk mund të ushtrojë veprimitari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimitaria përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit të Autoritetit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitme ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjera fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet kushti i mëposhtëm:

- a) veprimitaria dhe/ose disa veprimitari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin e parashikuar nga ligji.

Neni 22

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

1. Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët e Autoritetit Rrugor Shqiptar bëhen sipas kreut IV të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005.

2. Disa nga mënyrat bazë të mënjanimit të konfliktit të interest janë:

- t'i kufizohen zyrtarit informacione të caktuara, që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij;
- të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
- të mos lejohet që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
- të rishikohen ose të ndryshohen detyrat dhe kompetencat e zyrtarit;
- të transferohet zyrtari në një detyrë tjetër, që shmanget konfliktin e interesave;
- të merren masat e nevojshme për të shmanget emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;

- në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anulohen ose të revokohen, aktet e marra nga zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur, dhe mundësishët para se ato të kenë sjellë pasoja;
- anullimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;
- anullimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori i zyrtarit, kur ai vlerëson se pasojet që mund të vijnë nga anullimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

Neni 23 Sanksionet

Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar dhe Ligjin nr. 9049 datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, përbëjnë sipas rastit shkelje disiplinore, kundërvajtje administrative apo vepër penale, dhe ndëshkohen sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Neni 24 Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregullore nuk mund të interpretohet sikur u jep zyrtarëve të Autoritetit Rrugor Shqiptar të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt, që synon cenimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, apo Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

2. Në çdo rast që specifikimet në këtë rregullore bien ndesh me dispozitat e përcaktuara në Ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, apo Ligjin nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre, këto të fundit kanë prioritet dhe zbatohen drejtpërdrejt. Gjithashtu, dispozitat e këtyre ligjeve e akteve nënligjore zbatohen drejtpërdrejt, për aq sa nuk ka specifikime në zbatim të tyre në këtë rregullore.

Neni 25 Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padekuarura nga zyrtarët e Autoritetit Rrugor Shqiptar, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

a. zyrtari, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnje kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues, dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;

b. kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij nenit bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a. kur zyrtari:

i. ose është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;

ii. ose vetëpërjashtimi i tij është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;

iii. ose për shkak se asnjerë nga zgjidhjet e parashikuara në nenin 24, pika 2 të kësaj rregulloreje nuk është e mundur;

b. dhe kur:

i. vendimet e zyrtarit, sipas rregullimeve e ligj, nuk i nënshtronen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;

ii. nuk është i mundur as transferimi a tjetërsimi i interest privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);

iii. nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari I të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtronen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga eprori ose nga institucioni epror, të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen publike.

Neni 26

Njoftimi i rregullores punonjësve dhe trajnimet për rregulloren

1. Rregullorja i bëhet e njobur çdo punonjësi të institucionit nëpërmjet dërgimit në postën elektronike zyrtare, nëse ka, ose dhënies së një kopje të saj, secilit punonjës të punësuar në kohën e miratimit të saj apo në momentin që punësohet në institucion.

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme merr masa për njobjen e saj nga çdo zyrtar nëpërmjet trajnimeve të cilat planifikohen, në bashkëpunim me Drejtorinë juridike dhe Përputhshmërisë së Standarteve, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 27
Hyrja në fuqi, shpallja

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me miratimin e saj nga Bordi Drejtues i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe ndryshohet vetëm me miratim të tij.
2. Kjo rregullore, menjëherë me miratimin e saj, shpallet në një vend të dukshëm të institucionit dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Rrugor Shqiptar.